



**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Drzavnog Tuzioca / Office
of the Chief State Prosecutor**

A.nr. 557/2015

Datë: 30 dhjetor 2015

Prishtinë

Kryeprokurori i Shtetit, në pajtim me nenin 1 i cili i referohet nenit 11 par.1 pikat: 1.1 dhe 1.5, nenit 4 që i referohet nenit 13 par.7 dhe par.8 të Ligjit nr.05/L-034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, nenit 24 par.1 pika 1.2 të Ligjit nr.03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, dhe nenit 12 par.12.2 pika 12.2.4 të Rregullores nr.03/2015 për Emërimin e Kryeprokurorëve, në funksion të qenurit në dijeni në raport me rastet penale të natyrës së korrupsionit dhe krimeve ekonomike që kanë në punë të gjitha prokuroritë e që i referohen situatave për persona zyrtar në pozita të larta udhëheqëse, me qëllim të ngritjes së efikasitetit të ndjekjes penale, forcimit të ligjshmërisë, mbrojtjen e të drejtave, interesave dhe lirive të qytetarëve, intensifikimin e luftës kundër kriminalitetit të natyrës korruptive dhe krimeve ekonomike, rritjen e transparencës dhe besimit të publikut në sistemin prokurorial, nxjerr si në vijim këtë:

UDHËZIM TË DETYRUESHËM

I. Të gjithë prokurorët e shtetit obligohen, që brenda afatit prej 5(pesë) ditësh, nga dita e pranimit të: raportit, informatës, parashtrës apo kallëzimit penal apo për ndonjë lëndë penale që aktualisht janë duke e trajtuar në fazën e procedurës paraprake penale ose nën hetim për vepër penale të natyrës së korrupsionit dhe krimeve ekonomike, që me arsye mund të besohet se ajo vepër penale të jetë kryer nga ndonjëri prej personave zyrtar aktual në pozita të larta udhëheqëse apo që kanë qenë më parë në pozita të tilla si: kryeministër, ministër, zëvendës ministër, deputet, prokuror, gjyqtar, sekretar permanent, drejtor i policisë, drejtor i doganave, drejtor i administratës tatimore, drejtor menaxhues të kompanive publike, drejtor menaxhues të gjitha agjencioneve të themeluara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, si dhe persona tjerë zyrtar në pozita të larta udhëheqëse, që të informojnë kryeprokurorin e zyrës së tyre.

II. Kryeprokurori i zyrës përkatëse, posa të pranoj informatën e tillë si në pikën I të këtij udhëzimi, brenda afatit prej 8(tetë) ditësh, obligohet ta informoj Kryeprokurorin e Shtetit për rastin në fjalë.

III. Në rast të mos informimit të saktë dhe me kohë ashtu si figuron në pikat I dhe II të këtij udhëzimi, prokurori i shtetit apo kryeprokurori i zyrës përkatëse do të bartin konsekuencat ligjore, ashtu si është e parashikuar me dispozitat e nenit 24 par.1 pika 1.2 të Ligjit nr.03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 12 par.12.2 pika 12.2.4 të Rregullores nr.03/2015 për Emërimin e Kryeprokurorëve.

IV. Ky udhëzim hyn në fuqi, ditën e nënshkrimit nga Kryeprokurori i Shtetit.

A r s y e t i m

Me qëllim të ngritjes së efikasitetit të ndjekjes penale si dhe intensifikimin e luftës kundër kriminalitetit të natyrës korruptive dhe krimeve ekonomike, sidomos në situatat kur kemi të bëjmë me persona zyrtar aktual në pozita të larta udhëheqëse apo që kanë qenë më parë në pozita të tilla, ashtu si figuron në pikën I të këtij udhëzimi, Kryeprokurori i Shtetit konsideron se përcjellja e informacioneve të këtilla sipas rendit ndërvarës institucional brenda afateve të sipërcekura, si në pikat I dhe II të këtij udhëzimi, do të reflektonte pozitivisht në mbarëvajtjen dhe përmbushjen e obligimeve ligjore të prokurorit të shtetit. Kjo aq më parë, që ndjekja penale e suksesshme e kryesve të mundshëm të veprave penale të natyrës korruptive dhe krimeve ekonomike të cilët i takojnë kategorisë së personave zyrtar të profilin të lartë udhëheqës, do të mundësoj zbatimin konsekuent të ligjshmërisë, mbrojtjen e të drejtave, interesave dhe lirive të qytetarëve si dhe rritjen e llogaridhënjes dhe besimit të publikut në sistemin prokurorial.

Andaj, nga arsyet e sipër cekura, ky udhëzim është nxjerr dhe i njëjti do të iu shërbej të gjithë prokurorëve të shtetit si dhe kryeprokurorëve të zyreve përkatëse.

KRYEPROKURORI I SHETIT

Aleksandër Lumezi

A - [Signature]



Udhëzimi i dërgohet:

-Të gjithë Kryeprokurorëve të Prokurorive Themelore dhe prokurorëve të shtetit nëpër ato prokurori,

-U.D të Kryeprokurorit të PSRK-së dhe prokurorëve të shtetit në atë prokurori,

-Arkivit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Obligohet sekretariati i ZKPSH, që këtë udhëzim ta publikoj në Web faqen e Prokurorit të Shtetit